

VENDIM
Nr. 108, datë 10.7.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SKATINA HEC” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SKATINA”, ME FUQI TË
INSTALUAR 2677 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5, germa “a”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Skatina HEC” sh.p.k., si dhe informacionin shtesë të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Skatina”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin me nr. 32, datë 9.3.2016, filloi procedurat për licencimin e shoqërisë “Skatina HEC” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Skatina” me fuqi të instaluar 2677 kw.

- Në mbledhjen e bordit të ERE-s, datë 19.4.2017, është evidentuar dokumenti i paplotësuar nga kjo shoqëri “Miratimi i pikës së lidhjes”.

- Shoqëria “Skatina HEC” sh.p.k., me shkresën nr. 110 Prot., datë 7.6.2017, ka paraqitur dokumentacionin plotësues si më poshtë:

- Miratim pikë lidhje “Skatina HEC” me nr. 1236/3 Prot., datë 24.5.2017.

- Marrëveshja e Lidhjes së Re me nr. 1236/2 Prot., datë 24.5.2017.

- Aplikimi i shoqërisë “Skatina HEC” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Skatina HEC” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Skatina”, me fuqi të instaluar 2677 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti